



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 10 /01/2024

VENDIM

NR. 5, DATË 10 /01/2024

MBI

**“ZGJEDHJEN E 1 (NJË) ANËTARI NË KOMISIONIN E PËRHERSHËM TË
PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, pika 1(i) dhe 1(j), në nenin 46, pikat 1, 2, 3 dhe 6 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 30, pika 3(b) dhe nenin 35 të Statutit të Universitetit të Arteve, në nenin 21, pika 2(b) dhe neni 25 të Rregullores së Universitetit të Arteve, në nenin 4, pikat 1(b) dhe 1(s) të Rregullores së Funkcionimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve, si dhe në Urdhrin Nr. 104, datë 27.10.2023 “Për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me Universitetin e Arteve të Z. Petrit Malaj, punonjës akademik nga kategoria “Profesor” në Fakultetin e Artit Skenik të Universitetit të Arteve” dhe Aktmarrëveshjen e lidhur për këtë qëllim, pas votimit, në mënyrë unanime,

V E N D O S I:

1. Të zgjedhë anëtarin e këtij Komisioni, nga Fakulteti i Artit Skenik, si më poshtë:

- PROF. ILIR MARTINI

2. Vendimi i kalon për dajeni Bordit të Administrimit në lidhje me efektin financiar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Asoc. Dr. Artan IBËRSHIMI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Prof. Asoc. Genci FUGA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK

Tiranë, 09.01.2014

Lënda: *Kërkesa për vetkandidim si anëtar në komisionin e përhershëm për promovimin e personelit akademik të UART*

Mbështetur në shkresën nr. 1167 prot. datë 20.12.2023, mbi vakancën në komisionin e përhershëm për promovimin e personelit akademik të UART, ju bëj me dije si më poshtë vijon:

Ky komision në praktikën e përzgjedhjes së tij, nga dy anëtarë për secilin fakultet dhe ku njëri nga këto anëtarë me konsensus është dekan i fakultetit.

Prandaj unë, Prof. Ilir Martini, dekan i FAS, i drejtohem anëtarëve të Senatit Akademik të UART që vetëkanditohem për plotësimin e vendit vakant të lënë nga ish dekan i FAS Prof. Petrit Malaj i cili është emëruar Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës, rezident.

Duke ju falenderuar për mirëkuptim.

Me respekt,

Prof. Ilir MARTINI

